



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.201/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Hasan Shala anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, nga subjekti politik LVV, pasi që lidhur me këto pretendime është vendosur me vendimin ZL. Anr.153/2017 të dates 12.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 12.10.2017, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën ka theksuar se me datë 12.10.2017, zyrtar të shtabit Zgjedhor të LDK-se kanë vërejtur ruajtur e printuar postimin e kandidatit të LVV-së për kryetar të Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, në të cilën shihet qartë se në një takim elektoral të tij në Prishtinë (sipas postimit të tij, në Kodrën e Trimave) janë përfshirë edhe fëmijë që nga fotot e postuara vërehet qartë se janë nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare. Me këtë rast është vepruar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dispozitën e nenit 5.2 të rregullës zgjedhore 13/2013. Gjithashtu, ka kërkuar nga PZAP që subjektit politik LVV-së ti shqiptohet masa e sanksionimit konform rregullave në fuqi.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur tri fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) të datës 13.10.2017, theksoj se menjëherë pasi që ka pranuar urdhrin nga PZAP-ja, ka ndërmarr masat përmirësuese lidhur me këtë çështje dhe ka larguar fotografën e publikuar në facebook, po ashtu ka theksuar se i ka informuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e saj për dispozitat e Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe nevojat për të zbatuar dispozitat e tij. Andaj LVV ka ndërmarr të gjitha masat për të evituar shkeljet e mundshme nga anëtarët, mbështetësit apo kandidatët për zgjedhjet lokale. Gjithashtu, LVV ka theksuar se kandidati për kryetar të komunës së Prishtinës nuk ka bërë fushatë duke përdorur fëmijë ashtu siç ka pretenduar ankimesi, por ka qenë i ftuar nga një familje në Kodrën Trimave në Prishtinë dhe ato foto janë publikuar në rrjetin social të kandidatit për kryetar të Prishtinës, Shpend Ahmeti.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur 3 fotografi ku shihet se janë larguar fotografit nga rrjeti social facebook.

Paneli, pasi që vlerësoj ankesën konstatoj se:

Ankesa është e pa lejuar

Meqenëse për të njëjtën çështje është vendosur me vendimin e PZAP-së, ZL.Anr.153/2017 të datës 12.10.2017, Paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike, rezulton se kjo çështje në fjalë është çështje e gjykuar (res iudicata).

Paneli në kuptim të nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 201/2017 më datën 16.10.2017.



Kryesuesi i Panelit

Adnan Korushevc

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.